



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha (udhëheqës ekipi), Fatlinda Podvorica dhe Shqiponja Krasniqi (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Zukë Zuka.


TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit | 5 |
| 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore | 6 |
| 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 8 |
| 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve..... | 24 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja | 30 |
| Shtojca II: Letër e konfirmimit | 32 |

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për këto Pasqyra. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore janë përgatitur në harmoni me kërkesat ligjore, me përjashtim të një gabimi teknik tek shpalosja e llogarive të arkëtueshme (ref çështjes A6).

Menaxhimi financiar dhe kontrolli - vazhdon të mbetet fusha më sfiduese e menaxhimit të përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), dhe si e tillë, kërkon shumë përmirësime sidomos në fushën e Subvencioneve, pagesën e obligimeve për fermerë dhe menaxhimin e pasurisë.

MBPZHR nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur zbatimit të rekomandimeve dhe si rezultat i saj, pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit paraprak kanë mbetur të pazbatuara.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i Pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të MBPZHR për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të këtij raporti.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të MBPZHR-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i Pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të MBPZHR për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është e pavarur nga subjektet e audituara. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet

mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin korrekt të menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë dhe ndihmën e ofruar gjatë procesit të auditimit.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë eventuale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit tek investimet kapitale, procedimi i pagesave dhe menaxhimi i subvencioneve/granteve. Po ashtu, menaxhimi i pasurisë si dhe shpalosja e llogarive të arkëtueshme kanë nevojë të përmirësohen.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ² | 2019 Realizimi | % e Realizimit 2019 | 2018 Realizimi | 2017 Realizimi |
|------------------------------|-------------------|----------------------------|----------------|---------------------|----------------|----------------|
| Burimet e Fondeve: | 58,977,962 | 58,413,199 | 54,938,293 | 94% | 52,675,811 | 50,811,220 |
| Granti i Qeverisë - Buxheti | 52,478,474 | 51,913,711 | 51,029,046 | 98% | 50,545,984 | 49,742,305 |
| Financimet nga huamarrjet | 3,633,000 | 3,633,000 | 3,404,476 | 94% | 2,006,038 | 516,714 |
| Klauzola investive | 2,183,333 | 2,183,333 | 12,000 | 1% | 0 | 0 |
| Të bartura nga viti paraprak | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 93,724 |
| Të hyrat vetjake | 183,155 | 183,155 | 110,151 | 60% | 123,789 | 56,042 |
| Te hyrat nga AKP | 500,000 | 500,000 | 382,620 | 77% | 0 | 0 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 402,435 |

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 564,763€. Ky është rezultat i shkurtimeve buxhetore me vendime të Qeverisë. Në vitin 2019, MBPZHR ka shpenzuar 94% të buxhetit final.

Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale të shpenzimeve sipas kategorive.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2019 Realizimi | % e Realizimit 2019 | 2018 Realizimi | 2017 Realizimi |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|---------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 58,977,962 | 58,413,199 | 54,938,293 | 94% | 52,675,811 | 50,811,220 |
| Pagat dhe Mëditjet | 2,601,599 | 2,619,825 | 2,619,825 | 100% | 2,547,323 | 2,330,329 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 3,363,681 | 4,277,681 | 3,938,577 | 92% | 3,648,813 | 2,416,802 |
| Shërbimet komunale | 135,660 | 102,671 | 70,328 | 68% | 78,921 | 100,826 |
| Subvencionet dhe Transferet | 46,877,022 | 45,963,022 | 45,768,940 | 100% | 43,667,249 | 43,868,507 |
| Investimet Kapitale | 6,000,000 | 5,450,000 | 2,540,622 | 47% | 2,733,505 | 2,094,756 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar, ishte rritur për 18,226€, sipas vendimit të Qeverisë . Nr.02/113 të dt. 05.11.2019;
- Buxheti për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar, ishte rritur për 914,000€, si rezultat i transfereve dhe rialokimeve buxhetore ndërmjet kategorive;
- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 914,000€, sipas vendimeve si rezultat i transfere dhe rialokime buxhetore ndërmjet kategorive; dhe
- Buxheti për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 550,000€, sipas vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore.

MBPZHR, kishte treguar performancë të mirë sa i përket ekzekutimit të buxhetit final prej 94%, me përjashtim të kategorisë së investimeve kapitale, ku kishte shpenzuar vetëm 47% të buxhetit final. Kjo ishte si pasojë e mos realizimit të projektit të paraparë nga klauzola e investimeve.

Sipas sqarimeve të ministrisë, kjo ka ndodhur për shkak të respektimit të procedurave të prokurimit të Bankës Botërore. Si pasojë, nënshkrimi i kontratës dhe realizimi i punimeve për projektin “Rehabilitimi dhe Modernizimi në Sistemin e Ujitjes në kompaninë rajonale të ujitjes Radoniqi dhe Dukagjini” kanë shkaktuar vonesa dhe nuk është arritur realizimi i pagesave sipas planifikimit të paraparë”.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ministria për vitin 2019 ishin në vlerë 2,324,319€. Të hyrat realizohen nga lëshimi i licencave, të hyrat nga qiraja e tokës së dhënë në shfrytëzim, taksat drusore, etj. Shuma 2,005,162€ apo rreth 86% e të hyrave totale janë realizuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), ndërsa pjesa tjetër është realizuar nga departamentet tjera.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (€)

| Përshkrimi | 2019 Pranimet | 2018 Pranimet | 2017 Pranimet |
|------------------|---------------|---------------|---------------|
| Të hyrat vetjake | 2,324,319 | 2,326,477 | 2,265,297 |
| Totali | 2,324,319 | 2,326,477 | 2,265,297 |

Në raport me vitin e kaluar vlera e të hyrave të realizuara është afërsisht e njëjtë me një zvogëlim të vogël 2,159€.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2019 ishte 2,619,825€, i cili ishte realizuar në tërësi. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 402 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 398. Ne kemi testuar 27 mostra për teste substanciale në vlerë 14,636€, si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Auditimi ynë ka identifikuar çështjet në vijim:

Çështja B1 - Dobësi në angazhimin e stafit me marrëveshjeve për shërbime të veçanta

Gjetja

Sipas nenit 12 pika 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

MBPZHR ka angazhuar gjithsejt 88 zyrtarë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MSHV) prej tyre 48 në ministri, 31 në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor (AZHB) dhe 9 në APK. Lidhur me këto, ne kemi identifikuar dobësitë në vijim:

- Nga rastet e mësipërme, 25 prej tyre (17 në Ministri, dhe 8 AZHB), Ministria nuk ka zbatuar ndonjë procedurë të rekrutimit sipas kërkesave ligjore; dhe
- Ndërsa, 51 zyrtarë të angazhuar me MSHV (26 në Ministri dhe 25 në AZHB nga 31 rastet e cekura me lart) kishin vazhduar nga vitet paraprake, ku periudha e angazhimit të këtyre zyrtarëve është më e gjatë se sa afati i përcaktuar me rregulla ligjore, mbi gjashtë muaj.

Sipas zyrtarëve të MBPZHR kjo kishte ndodhur për shkak të nevojës për staf dhe mos aprovimit të buxhetit për staf shtesë.

Ndikimi

Dobësitë e identifikuar mund të rezultojnë me mungesë të mirëfilltë të konkurrencës dhe cilësi të dobët të shërbimeve të ofruara. Në mungesë të kontroleve Ministria rrezikon rritje të shpenzimeve të pa planifikuara që mund të ndikojnë në ngecjen e realizimit të objektivave tjera të përcaktuara.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit, dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në Ministri (pozita të rregullta), të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje të përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, duke i procesuar përmes sistemit të pagave.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në vitin 2019 ishte 4,380,352€, ndërsa ishin shpenzuar 4,008,905€ apo 92%.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime, kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, mirëmbajtje, pajisje të IT-së, derivate, shpenzime të qirasë, shërbime kontraktuese, shërbime komunale, furnizim me preparate për laborator në Institutin Bujqësor në Pejë etj.

Ne kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 2,090,678€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Auditimi ynë ka identifikuar çështjet në vijim:

Çështja A1 - Lidhja e kontratës me OE për shërbime që mund të kryhen nga vetë Ministria, respektivisht Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK)

Gjetja Ligji për prokurim publik Nr. 04/L-042 me plotësim ndryshime, neni 9 përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, pika 1 specifikon që Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Po ashtu, pika 4 e këtij neni kërkon që nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

Megjithatë, kontrata "Përkrahja e Fermerëve për analiza të tokës, trajnime, këshillime dhe rekomandime për rezultatin e analizave të tokës" ishte nënshkruar me datë 22.06.2018 në vlerë 176,199€ me një operator ekonomik, përkundër faktit që analizat e tilla mund të realizohen nga Instituti Bujqësor i Kosovës që operon në kuadër të ministrisë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të vendimit të gabuar të menaxhmentit të MBPZHR-së për kontraktimin e kryerjes së këtyre shërbimeve.

Ndikimi Mos shfrytëzimi i resurseve njerëzore dhe teknologjike të cilat posedon Instituti Bujqësor dhe lidhja e kontratave me operator ekonomik privat ndikon në shpenzimin e pa arsyeshëm të fondeve buxhetore.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të shqyrtoj arsyet dhe nevojën për prokurimin e shërbimeve të cilat ka mund t'i kryej vet IBK-ja, si dhe të siguroj se para inicimit të çdo aktiviteti të prokurimit, merret parasysh neni 9.4 i LPP-së në mënyrë që të mos kontraktohen jashtë shërbimet të cilat mund t'i kryejnë organet/institutet që operojnë brenda vet ministrisë.

Çështja A2 - Mangësi në vendosjen e kriterëve tek aktiviteti i prokurimit**Gjetja**

Te aktivitetit i prokurim" Shërbime të përkthimit për nevojat e MBPZHR-së" në njoftimin për kontratë të datës 10/03/2017 tek neni III.2.4 kapaciteti teknik dhe profesional, një nga kërkesat ishte që OE të ketë 4 përkthyes, dy prej tyre përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas, si dhe dy përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhën serbe. Megjithatë, tek dëshmitë e kërkuara nuk ishin kërkuar dëshmi adekuate siç janë kantatat e punës apo para kontratat për të dokumentuar se OE ka të punësuar apo do të punësojë stafin e kërkuar. Në vend të tyre, ishin kërkuar si dëshmi CV-të, referencat e punës dhe diplomat e stafit.

Si pasojë kontrata ishte lidhur me Operatorin Ekonomik (OE) i cili nuk kishte ofruar dëshmi adekuate për të dokumentuar se ka staf të mjaftueshëm siç kërkohet në dosjen e tenderit, pra OE kishte ofruar referencat për të punësuarit të cilat ishin lëshuar në vitin 2016 . Kjo kishte ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur me rastin e vendosjes së kriterëve.

Ndikimi

Mos specifikimi dokumenteve adekuate për të dëshmuar se operatori ekonomik ka staf të mjaftueshëm për realizimin e shërbimeve, mund të ndikojë që të shpërblehet me kontratë OE i cili nuk ka staf të mjaftueshëm dhe si rrjedhojë, të ketë vështirësi në realizimin e shërbimeve.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të sigurojë se me rastin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, kriteret e përcaktuara nga departamenti i prokurimit duhet të jenë të qarta dhe dëshmitë e kërkuara të jenë në përputhje me kriteret e vendosura.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 45,963,022€. Prej tyre në vitin 2019 ishin shpenzuar 45,768,940€. Subvencionimi nga ministria bazohet në Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural/PBZHR 2014-2020. Zbatimi i këtij programi bëhet në baza vjetore sipas Programit për Zhvillim Rural dhe Programit për Pagesa Direkte. Hartimi i këtyre politikave bëhet nga departamenti për Zhvillimin e Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, si dhe nga Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural. Implementimi i tyre bëhet nga AZHB-ja, ndërsa pagesa e tyre realizohet nga departamenti i financave të ministrisë.

Në këtë fushë, ne kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 3,102,059€, dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Mangësitë identifikuar janë si në vijim:

Çështja A3 -Mos specifikimi i afateve në programe dhe UA 16/2019 për grante dhe UA 17/2019 për Pagesat Direkte si dhe vonesa në aprovim

Gjetja Programi për pagesa direkte 2019 dhe Udhëzimi Administrativ 17/2019 si dhe Udhëzimi Administrativ për grante 16/2019 duhet të kenë të përcaktuara qartë afatet kohore për aprovim dhe realizim të pagesave.

Në udhëzimin administrativ 16/2019 për grante, neni 28, paragrafi 3 dhe 4 thuhet se procedimi administrativ përfundon në periudhën brenda 45 ditëve nga pranimi i aplikacionit deri tek letër informimi mbi vlerësimin e aplikacionit. Ndërsa sipas të njëjtit udhëzim, nuk përcaktohet ndonjë afat kohor prej letër informimit të vlerësimit të aplikacionit e deri te Miratimi i projektit.

Ne kemi vërejtur se MBPZHR nuk ka të përcaktuar afatin kohor për aprovimin e Programit të Pagesave Direkte . Ky program ishte aprovuar më 27.05.2019. Ky fakt ka shkaktuar vonesë në procesin e subvencionimit duke filluar nga thirrja për aplikim, kontrollet në terren e deri te finalizimi i pagesës.

Ne kemi identifikuar se në katër raste aplikimi ishte bërë në muajin mars 2018 ndërsa pagesat në vlerë 110,247€ ishin realizuar pas një viti, në muajin mars 2019.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë me rastin e hartimit të programit dhe udhëzimeve administrative për subvencione dhe grante.

Ndikimi Realizimi i programeve me vonesë mund të rezultojë me vonesa në implementimin e Projekteve nga ana e farmerëve dhe bartjen e obligimeve kontraktuale/financiare për vitet në vijim. Mungesa e afateve për pagesa direkte dhe mungesa e afateve pas procedimit administrativ tek grantet, mund të ndikoj që objektivat vjetore të ministrisë të mos arrihen.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj që Autoriteti menaxhues harton programin me kohë me qëllim të implementimit të masave në kohën e duhur. Po ashtu, të siguroj se janë vendosur afate për pagesa direkte në pajtim me alokimet buxhetore, dhe varësisht nga disponueshmëria e fondeve buxhetore, të vendosen edhe afatet për miratimin e projekteve për grante.

Çështja B2 - Keq klasifikim i paradhënive të granteve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare 01/2013-Shpenzimi i parave publike, neni 18-Inicimi i Shpenzimeve, pika 3. Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.

Në katër raste kemi vërejtur se avanset për grante ishin regjistruar si shpenzime në kode të ndryshme, ku prej tyre tri pagesa në vlerë 202,152€ ishin regjistruar në kodin ekonomik 23210 (ristrukturimi i potencialit fizik), ndërsa një pagesë 79,999€ ishte regjistruar në kodin 23220 (menaxhimi i burimit të ujitjes në bujqësi). Këto pagesa ishte dashur të regjistrohen si avanse.

Kjo ka ndodhur pasi që nuk është paraparë kod i veçantë në planin kontabël dhe ministria nuk kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për hapjen e një kodi të veçantë që rregullon natyrën e këtyre pagesave.

Ndikimi Realizimi i shpenzimeve nga kodi jo-adekuat, shkakton paqartësi në raportin e shpenzimeve të ndodhura, si dhe rrit rrezikun për paraqitje jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet të regjistrohen në kodin ekonomik adekuat sipas rregullave financiare dhe udhëzimeve administrative në fuqi, në rast se asnjë nga kodet në plan kontabël nuk përputhet, atëherë duhet të kërkohet nga Thesari shtimi i një kodi të ri për paradhëniet e subvencioneve/granteve.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2019 ishte 5,450,000€, ndërsa ishin shpenzuar 2,540,621€ apo 47%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes, rehabilitimin e rrjetit rrugor në zonat vreshtare, sistemi i integruar informativ bujqësor, ngritja e kapaciteteve laboratorike, etj.

Prej 24 mostrave të përzgjedhura për teste substanciale në vlerë 1,904,554€, dhe pesë (5) mostrave për teste të pajtueshmërisë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja B3 - Vonesa në realizimin e projekteve dhe shpenzime shtesë si pasojë e hartimit të dobët të projekteve dhe specifikimeve teknike nga njësitë kërkuese

Gjetja

Ligji i Prokurimit Publik neni 28 pika 10 parasheh se “Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t’i bashkëngjitet Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.”. Në kontratat e nënshkruara ndërmjet MBPZHR-së dhe Operatorëve Ekonomik (OE) për realizimin e projekteve kapitale, përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve sipas planit dinamik dhe, gjithashtu, parashihet aplikimi i ndëshkimeve në rast të vonesave të paarsyetuara.

Ne kemi identifikuar dy raste ku punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë. MBPZHR ka lidhur aneks kontrata për punë shtesë të cilat kishin rezultuar me një kosto prej 246,750€, të cilat kishin ndodhur si rezultat i projekteve jo të duhura teknike dhe specifikimeve të mangëta teknike të cilat ishin hasur në terren gjatë implementimit të projekteve:

- Projekti i zgjerimit të ujitjes në fshatin Pantinë dhe Samadraxhë-Vushtrri. Kontrata është nënshkruar me datë 31.07.2017 me OE në vlerë financiare prej 538,299€. Afati për kryerjen e punimeve ka qene 128 ditë pune. Me datën 17.12.2018 është bërë edhe një aneks kontratë shtesë në vlerë prej 49,015€. Pranimi teknik është bërë me datën 18.07.2019; dhe
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në fshatrat Piranë, Landovicë, Tupec dhe Krajk (Komuna e Prizerenit). Kontrata është nënshkruar me datë 25.10.2017 me OE. Kontrata është nënshkruar në vlerë prej 633,089€, afati për kryerjen e punimeve ka qenë 123 ditë pune.

Me datën 25.07.2018 është nënshkruar kontrata në vlerë prej 135,220€, për vazhdimin e zgjerimit të sistemit ujitës për projektin e lartë cekur. Afati për kryerjen e punimeve ka qenë 28 ditë pune, pastaj me datë 11.12.2018 është lidhur një aneks kontratë shtesë në vlerë prej 62,515€ ku punimet për këtë aneks kontratë kanë përfunduar me datën 25.03.2019. Pranimi teknik është bërë me datën 21.10.2019.

Vonesat në kryerjen e punimeve ishin rezultat i projekteve jo të duhura teknike dhe specifikimeve të mangëta teknike, ku gjatë implementimit të projektit në terren kishin dalë punime shtesë dhe ndërrime të destinacioneve për vendosjen e gypave për ujitje, të cilat nuk kishin qenë të përfshira në kontratën fillestare. Ndërsa pranimiti teknik është bërë me vonesë për arsye të kushteve atmosferike (lëshuarjen e ujit) nga Hidrosistemi Ibër Lepenc.

Ndikimi Mos hartimi i duhur i specifikimeve rritë rrezikun e implementimit të projekteve sipas standardeve teknike të ndërtimit, si dhe vonesat në realizimin e tyre. Kjo, gjithashtu, ndikon edhe në rritjen e kostove përfundimare të projekteve dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara vjetore të ministrisë.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të sigurojë se para përpilimit të dosjes së tenderit, projektet e përcaktuara të kenë specifikacionet e plota dhe të qarta të gjitha pozicioneve të punëve ndërtimore nga njësitë kërkuese në mënyrë që zbatimi i projekteve të realizohet në kohë dhe në mënyrë cilësore.

Çështja A4- Vonesë në njoftimin për nënshkrim të kontratës

Gjetja Sipas nenit 41/A të LPP-së Njoftimi për nënshkrimin e kontratës thotë “Nëse autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, të negociuara pa publikim, procedurat e kuotimit të çmimeve, ose procedurat me vlera minimale, Autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas nënshkrimit të kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin për nënshkrimin e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji”.

MBPZHR me datën 13.09.2019 kishte zhvilluar aktivitetin e prokurimit për projektin kapital Ngritja e Kapaciteteve Laboratorike në Institutin Bujqësor të Kosovës-Pejë (IBK). Kontrata ishte nënshkruar me datën 12.11.2019, ndërsa, njoftimi për nënshkrim të kontratës është bërë me 16.12.2019, përkatësisht pas 32 ditë kalendarike vonesë.

Lidhur me këtë, menaxhmenti i MBPZHR nuk na ka dhënë sqarime lidhur me arsyen e vonesave të këtij njoftimi.

Ndikimi Vonesat për njoftimin e dhënies së kontratës, mund të ndikojnë që Operatori Ekonomik të mos arrij të realizojë furnizimet apo shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, e cila mandej do të reflektohet në realizimin e objektivave të ministrisë.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të sigurojë nivelin adekuat të përgjegjësisë në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për dhënien e kontratës sipas kërkesave në Ligjin e Prokurimit Publik.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e paraqitur në PFV e pasurive kapitale (mbi 1,000€) është 43,350,976€, vlera e pasurive jokapitale 346,375€, dhe e stoqeve 60,487€.

Auditimi ynë ka identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja A5 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Rregullorja nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 12 paragrafi 2 dhe 3 përcakton se: “Deri në momentin e pranimit të pasurisë jo financiare organizatat buxhetore financuese do të regjistrojnë transaksion në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimit nga ana e organizatës buxhetore, e cila e fiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë përkatëse, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e organizatës buxhetore pranuese dhe organizatës buxhetore bashkë financuese”.

Ne kemi vërejtur se Projekti kapital për “Sistemin e ujitjes për vendbanimet: Piranë, Landovicë, Tupec dhe Krajk-KK Prizren” ka përfunduar dhe është bërë pranimi teknik me 21.10.2019, ndërsa në regjistrat e pasurisë të MBPZHR kjo vazhdon të jetë e regjistruar si investime në vijim në vlerë 830,435€.

Në anën tjetër, vlera e pasurive kapitale e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 52,892€, të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurisë, ndërsa vlera e pasurive nën 1,000€ e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë, pra ishte mbivlerësuar për 5,000€ për arsye që disa pasuri me vlerë mbi 1000€ ishin regjistruar në SIMFK dhe sistemin e-pasuria.

Po ashtu, pronat tokësore të Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK) në vlerë 8,378,511€, ende nuk kontrollohen dhe shfrytëzohen nga IBK, por të njëjtat shfrytëzohen nga individët privat. Ky vlerësim është bazuar në të dhënat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) ku titullar i pronave figuron IBK. Kjo e gjetur ishte paraqitur edhe në raportet e viteve paraprake.

Mangësitë e vërejtura janë si pasojë e mungesës së kontrollit lidhur me identifikimin e gabimeve në regjistrat e pasurisë, regjistrimet e gabuara në sistem, si dhe në rast të veçantë për mos koordinim ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe njësisve tjera për tu informuar lidhur me projektin e përfunduar dhe mos komunikimi me komunën për të bërë bartjen e pasurisë në llogaritë e tyre.

Ndikimi Mungesa e informatave të plota dhe të sakta lidhur me pasurinë në dispozicion të MBPZHR-së ndikon në menaxhim jo të mirë të pasurive dhe prezantim jo të drejtë në PVF, në rastin konkret mbajtja e pasurisë si investim në vijim pamundëson amortizimin e sajë dhe kjo ndikon në mbivlerësim të pasurisë.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat e sakta në lidhje me regjistrin e pasurisë. Veç kësaj, për projektet e përfunduara të finalizoj procesin për bartjen e pronësisë tek komuna dhe të njëjtat t'i heq nga regjistrat.

Çështja C1 - Mos regjistrimi i pasurisë jo financiare dhe mos harmonizimi i regjistrit të inventarizimit me regjistrin e pasurisë

Gjetja Rregullorja Nr. 02-2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, neni 6, paragrafi 3: " kërkon që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Më tutje, Neni 19 i rregullores së cekur më lartë, përcakton që komisioni për inventarizimin e pasurisë të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë dhe të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Auditimi ynë ka identifikuar mangësitë në vijim:

- Pasuria kapitale (mbi 1000€) ishte nënvlerësuar pasi pagesa në vlerë 52,892€ (investime në vijim) nuk ishte regjistruar në SIMFK; dhe
- Pasuria jo kapitale (nën 1000€) ishte mbivlerësuar, pasi që 5 pajisje: dy Klimatik për tharjen e mostrave , vlera e blerjes për secilën nga 1,000€ dhe tri Peshore teknike 2200g / 0.01 mg vlera e blerjes për secilën nga 1,000€, (gjithsej 5,000€), këto pasuri ishin regjistruar në SIMFK, po ashtu gabimisht ishin regjistruar edhe në sistemin e-pasuria.

Komisioni kishte kryer me kohë inventarizimin për vitin 2019, mirëpo nuk kishte harmonizuar gjendjen e inventarizuar me regjistrat e pasurive jo financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme si dhe për shkak të neglizhencës së zyrtarëve për të bërë harmonizimin e gjendjes së inventarizimit me regjistrin e pasurisë.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë si dhe mos harmonizimi i regjistrit të inventarizimit me regjistrat e pasurive jo financiare, ndikon në prezantim jo të drejtë të pasurive në PVF dhe njëherit rrit rrezikun që pasuritë të humbin apo keqpërdoren.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë, siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Njëherësh të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të reflektoj ndryshimet eventuale në PVF.

2.3 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në PVF 2019 ishte 3,447,906€, mirëpo kjo vlerë është e mbivlerësuar për 114,100€.

Llogaritë e Arkëtueshme kryesisht kanë të bëjnë me qiratë. Pjesa më e madhe i përkasin APK-së dhe kanë të bëjnë me obligimin që kanë OE ndaj APK-së për ri-kultivimin e tokave pas shfrytëzimit të tyre. APK në shumicën e rasteve kishte bërë padi ndaj OE të cilët nuk kishin kryer me kohë obligimet ndaj APK-së.

Auditimi ynë ka identifikuar mangësitë në vijim:

Çështja A6 - Mbivlerësimi i Llogarive të arkëtueshme në PVF

Gjetja Sipas rreg. 01/2017 Për raportim vjetor nga Organizata Buxhetore, Neni 16, Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të obliguara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Ne kemi vërejtur se Shpalosja e llogarive të arkëtueshme nuk ishte pasqyruar drejt në PVF. Vlera e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në PVF ishte mbivlerësuar pasi që të hyrat e realizuara në vlerë 114,101€ ishin prezantuar si llogari të arkëtueshme.

Kjo ka ndodhur pasi që, MBPZHR nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm duke mos i verifikuar saktë se cilat lëndë janë paguar e cilat jo.

Ndikimi Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme ndikon në prezantim jo të drejtë të llogarive në PVF.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të sigurojë me rastin e përgatitjes së PVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në PVF në fund të vitit 2019, ishte 8,232,624€. Prej tyre, 8,100,870€ apo 98% janë obligime ndaj fermerëve, të cilat janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Arsye e mos shlyerjes së këtyre obligimeve janë: pranimi i disa faturave me vonesë, dhe mos kompletimi i dokumentacionit.

Vlera e obligimeve të papaguara mbetet shumë e lartë, dhe kjo çështje është duke u përsëritur ndër vite.

Çështja B4 - Vonesa në realizimin e pagesave të obligimeve

Gjetja Afatet kohore për kryerjen e pagesave të granteve përcaktohen me udhëzuesit që i nxjerr ministria për zbatimin e programeve vjetore të aprovuara. Në bazë të këtyre udhëzuesve, pagesat duhet të bëhen 20 ditë pas marrjes së vendimit apo 40 ditë nga data e aplikimit për pagesë, përveç nëse tejkalimi i afatit bëhet për ndonjë arsye objektive.

Nga 100 mostrat e ekzaminuara, në 35 raste në vlerë totale 1,653,384€, kemi vërejtur se pagesat kishin tejkaluar afatet e përcaktuara për pagesë. Vonesat në rastet e ekzaminuara ishin deri në gjashtë muaj. Sipas shpjegimeve të menaxhmentit të ministrisë, kjo ishte si rezultat i mos alokimeve të duhura të buxhetit për shpenzim nga ana e ministrisë së financave.

Ndikimi Praktikrat e tilla të ministrisë shkaktojnë probleme serioze për fermerët apo përfituesit e këtyre fondeve, për shkak se të njëjtit mund të fillojnë aktivitetet dhe të hyjnë në obligime duke u bazuar në pagesat apo kompensimet që do t'i bëjë ministria.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të siguroj se asnjë ndarje e subvencioneve dhe granteve nga ana e komisioneve përkatëse nuk do të bëhet para se fondet të jenë të sigurta dhe të gatshme për pagesë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore. Problemet me alokimin e fondeve duhet të zgjidhen në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

Vlera e detyrimeve kontingjente e prezantuar në PVF ishte 912,349€.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4.3 Detyrimet e kontraktuara

Vlera e detyrimeve të kontraktuara sipas raporteve të MBPZHR-së është 18,021,677€.

Detyrimet kontraktuara kanë të bëjnë kryesisht me kategorinë e subvencioneve dhe tranferëve. Arsyeja e mos procedimit tutje të këtyre obligimeve kontraktuale është vonesa e nënshkrimit, nga ana e Ministrit të MBPZHR-së, të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe afatet e parapara brenda Udhëzimeve Administrativ: U/A Nr.16/2019 për masat dhe kriteret e përkrahjes për Zhvillimin Rural për vitin 2019 dhe U/A Nr.18/2019.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit – UD/Drejtori i NjAB-së dhe dy auditorë. Auditimet kryhen sipas planit strategjik dhe vjetor dhe përfshijnë fushat me më shumë ndjeshmëri dhe rrezik.

Përveç Planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës ku ishin përcaktuar disa fusha për auditim për vitin 2019.

NjAB për vitin 2019 ka planifikuar dhjetë (10) auditime, prej të cilave gjatë vitit 2019 ka përfunduar tetë (8) auditime sipas planit vjetor të punës 2019, ndërsa dy (2) auditime të planifikuara për APK janë realizuar nga NJAB e APK-së pasi që, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 është funksionalizuar kjo njësi. Raportet e auditimit përmbajnë konkluzione dhe rekomandime të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të MBPZHR-së.

Po ashtu, në kuadër të MBPZHR operojnë edhe dy Njësi të veçanta të Auditimit të Brendshëm, njëra në kuadër të AZHB-së (e themeluar në vitin 2018) e cila përbehet nga 2 anëtar të stafit –Drejtori i NJAB dhe një auditor, ndërsa tjetra në APK që operon vetëm me një auditor e që është themeluar në vitin 2019 bazuar në Rregulloren NR .16/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës e cila ishte e aprovuar në Qeveri.

APK pas themelimit të NJAB-it me datë 04.12.2019 kishte bërë kërkesë në NJQHAB-MF që kjo njësi të bëhet pjesë e databazës së NJQH/AB-MF, në mënyrë që të zbatojë legjislacionin në fuqi për përmbushjen e obligimeve ndaj NJQH/AB , duke zbatuar raportimin e rregullt dhe duke marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet të cilat kjo njësi i organizon për njësitë gjegjëse të Auditimit të Brendshëm në nivel të Institucioneve Publike të Republikës së Kosovës, por ende APK nuk kishte marrë përgjigje nga NJQH/AB. Megjithatë, APK duhet të përsërisë kërkesën në NJQH/MF dhe në bashkëpunim me NJQH/AB t'i mundësoj NJAB në APK të bëhet pjesë e kësaj databaze.

MBPZHR ka themeluar Komitetin e Auditimit në mars të vitit 2019, komiteti përbëhet nga tre anëtarë (dy anëtarë të jashtëm dhe një anëtar i brendshëm). Gjatë vitit 2019 kishte mbajtur pesë takime ku dhe janë përpiluar edhe procesverbale.

Auditimi ynë ka identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja A7- Mangësi në realizimin e planit vjetor të punës në AZHB

- Gjetja** Sipas planit vjetor të punës për vitin 2019 NJAB në AZHB e cila operon me dy anëtarë të stafit – Drejtori i NJAB-së dhe një auditorë, kishte planifikuar të kryej 13 auditime për vitin 2019.
- Megjithatë, gjatë 2019 kishte përfunduar vetëm dy auditime (një raport me kërkesë për “Procedurat e kthimit të avanceve nga përfituesit e granteve të Programit të Zhvillimit Rural 2015, Nënmasa 103.3 – Përpunimi i pemëve dhe perimeve”, si dhe një memorandum për kryerjen e auditimit të mostrave për vitin 2012 në kuadër të auditimit me kërkesë për “PZHR 2012-2018”).
- Sipas Drejtorit të NJAB-së në AZHB-së, ngecjet në realizimin e planit vjetor 2019 janë pasojë e mungesës së stafit auditues dhe auditimet me kërkesë me fushëveprim të gjerë.
- Rreziku** Mos realizimi i planit vjetor të punës së NJAB-it ndikon në mos identifikimin e mangësive në sistemin e kontrollit të brendshëm të AZHB-së dhe si pasojë mos ndërmarrjen e masave të nevojshme nga menaxhmenti në kohë reale për eliminim e mangësive të cilat shkaktojnë pengesa në realizimin e objektivave të AZHB-së.
- Rekomandimi A7** Ministri/ Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së duhet të sigurojë që NJAB e AZHB-së të jetë funksionale me kapacitete të mjaftueshme në mënyrë që të përfundoj auditimet e planifikuara me planin vjetor të punës dhe që fushëveprimi i NJAB-së të fokusohet në vitin aktual.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 kishte rezultuar në 14 rekomandime. Për këto, MBPZHR kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019: pesë (5) rekomandime ishin zbatuar, një (1) ishte në proces të zbatimit, shtatë (7) rekomandime ishin të pazbatuara, dhe një (1) konsiderohen i mbyllur i pazbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4.

MBPZHR nuk ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2018 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|-------------------|--|--|-------------|
| 1 | PVF | Ministrja duhet të siguroj shpalosjen e saktë të të gjitha informatave në PFV, përfshirë informatat në lidhje me pasuritë, pasuritë kontingjente dhe detyrimet kontingjente. Kësaj duhet t'i paraprij evidentimi dhe regjistrimi i tyre në regjistrat e ministrisë. Po ashtu, Ministrja dhe Drejtori i Përgjithshëm i IBK-së duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprimet e duhura ligjore që pasuritë e shfrytëzuara nga personat privat të rikthehen nën kontroll të IBK-së | Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi. | I pazbatuar |
| 2 | PVF | Ministrja duhet të siguroj monitorim sistematik të shpenzimit të buxhetit. Për tejkalimin e barrierave eventuale të identifikuar, duhet të përcaktohen masa konkrete dhe praktike në mënyrë që ekzekutimi i buxhetit të bëhet në harmoni me planin e shpenzimeve. Programet vjetore të bujqësisë duhet të aprovohen me kohë, për të mundësuar shmangien e bartjes së vazhdueshme të obligimeve për vitin pasues. | Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi. | I pazbatuar |

| | | | | |
|---|----------------------------------|---|--|-------------|
| 3 | PVF | Ministrja duhet t'i shqyrtoj arsyet pse rastet e tilla kanë ndodhur, dhe të ndërpres praktikat e angazhimit të përkohshëm të stafit për pozitat e rregullta. Në rast të nevojave për shërbime të veçanta, ato duhet të sigurohen duke ju nënshtruar kërkesave dhe procedurave ligjore | Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi. | I pazbatuar |
| 4 | Subvencion e dhe Transfere | Ministrja duhet të kërkojë nga personat përgjegjës forcimin e mekanizmave për menaxhim dhe monitorim të shpenzimeve në fjalë, në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme që paratë e dhëna të shfrytëzohen drejtë dhe në pajtim me objektivat e subvencioneve. | Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2019. | I zbatuar |
| 5 | Subvencion e dhe Transfere | Ministrja duhet të forcojë kontrollet e aprovimit të pagesave, për përkrahjen e GLV-ve, dhe në rastet ku raportimi i tyre nuk është në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara dhe me projektin e miratuar, të kërkohet kthimi i mjeteve siç parashihet me udhëzim dhe rregulloret tjera. | Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2019. | I zbatuar |
| 6 | Investimet Kapitale | Ministrja të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në përpilimin e specifikacioneve teknike nga njësitë kërkuese para përgatitjes së dosjes së tenderit në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë. | Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi. | I pazbatuar |
| 7 | Investimet Kapitale | Ministrja duhet të sigurojë që zyrtari i shpenzimeve e bënë klasifikimin e duhur të shpenzimeve nëpër llogaritë përkatëse sipas planit kontabël dhe rrjedhimisht edhe në pasqyra financiare. Në rast se asnjë nga kodet në plan kontabël nuk përputhet, atëherë duhet të kërkohet nga Thesari shtimi i një kodi të ri për sistemin e ujitjes. | Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi. | I pazbatuar |
| 8 | Çështje të përbashkët | Ministrja duhet të vendos disiplinë financiare dhe të kërkoj nga zyrtarët | Nuk janë ndërmarrë veprime | I pazbatuar |

| | | | | |
|----|--------------------------------|--|---|----------------------|
| | a M&SH dhe I&K | financiar që me përpikëri të zbatojnë procedurat e shpenzimeve, dhe të gjitha faturat të paguhen brenda afateve të përcaktuara ligjore. | për zbatimin e këtij rekomandimi. | |
| 9 | Menaxhimi i Pasurive | Ministrja duhet të inicoj hartimin e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë dhe të siguroj një menaxhim më efektiv dhe në pajtim me rregullat. Po ashtu, duhet të sigurojë që komisioni i për inventarizim të bëjë harmonizimin e raportit të inventarizimit të pasurive me regjistrat e organizatës para përgatitjes së PFV-ve të vitit 2019. Përveç kësaj, të gjitha pajisjet duhet të evidentohen në regjistrat e pasurive. | Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi. | I pazbatuar |
| 10 | Menaxhimi i Pasurive | Ministrja duhet të sigurojë që me rastin e blerjes së mallrave, të caktohen komisionet për pranimin e tyre konform dispozitave të rregullores në fuqi. Po ashtu duhet të sigurohet se pajisjet të futen në funksion menjëherë pas blerjes, në mënyrë që ato të mos amortizohen duke qëndruar të pa përdorura. | Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2019. | I zbatuar |
| 11 | Llogaritë e Arkëtueshme | Ministrja duhet të sigurojë monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënien me qira të tokave bujqësore, në mënyrë që të sigurohet se kontraktuesit i kryejnë obligimet e tyre sipas marrëveshjes, në të kundërtën kontratat duhet të ndërpriten. | Në shumicën e rasteve me rastin e pagesave janë bërë padi ndaj atyre që nuk kanë kryer obligimet sipas kontratës. | Pjesërisht i zbatuar |
| 12 | Obligimet e papaguara | Ministrja duhet të siguroj se asnjë ndarje e subvencioneve dhe granteve nga ana e komisioneve përkatëse nuk do të bëhet para se fondet të jenë të sigurta dhe të gatshme për pagesë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren. Problemet me alokimin e fondeve duhet të zgjidhen në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. | Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë vitit 2019. | I zbatuar |

| | | | | |
|-----------|--|--|--|-----------------------|
| 13 | Auditimi i Brendshëm | Ministrja duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit i Auditimit, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. | Komiteti i Auditimit është funksional | I zbatuar |
| 14 | Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut | Ministrja duhet të sigurojë ndërmarrjen e masave të nevojshme për procedimin e rregullores në Qeveri për aprovim, si parakusht për funksionalizimin e plotë të të gjitha departamenteve në kuadër të AzhB-së. | Nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi, megjithatë për shkak të ndryshimit të formatit të raportit të auditimit nuk do të përsëritet. | I mbyllur i pazbatuar |
| Nr | Fusha e auditimit | Rekomandimet e vitit 2019 | | |
| 1 | Pagat dhe mëditjet | Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit, dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në Ministri (pozita të rregullta), të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje të përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, duke i proceduar përmes sistemit të pagave. | | |
| 2 | Mallra dhe shërbimet | Ministri duhet të shqyrtoj arsyet dhe nevojën për prokurimin e shërbimeve të cilat ka mund t'i kryej vet IBK-ja, si dhe të siguroj se para inicimit të çdo aktiviteti të prokurimit, merret parasysh neni 9.4 i LPP-së në mënyrë që të mos kontraktohen jashtë shërbimet të cilat mund t'i kryejnë organet/institutet që operojnë brenda vet ministrisë. | | |
| 3 | Mallra dhe shërbimet | Ministri duhet të sigurojë se me rastin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, kriteret e përcaktuara nga departamenti i prokurimit duhet të jenë të qarta dhe dëshmitë e kërkuara të jenë në përputhje me kriteret e vendosura. | | |

| | | |
|----|----------------------------------|---|
| 4 | Subvencion et dhe tranferet | Ministri duhet të siguroj që Autoriteti menaxhues harton programin me kohë me qëllim të implementimit të masave në kohën e duhur. Po ashtu, të siguroj se janë vendosur afate për pagesa direkte në pajtim me alokimet buxhetore, dhe varësisht nga disponueshmëria i fondeve buxhetore, të vendosen edhe afatet për miratimin e projekteve për grante. |
| 5 | Subvencion et dhe tranferet | Ministri duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet të regjistrohen në kodin ekonomik adekuat sipas rregullave financiare dhe udhëzimeve administrative në fuqi, në rast se asnjë nga kodet në plan kontabël nuk përputhet, atëherë duhet të kërkohet nga Thesari shtimi i një kodi të ri për paradhëniet e subvencioneve/granteve. |
| 6 | Investimet Kapitale | Ministri duhet të sigurojë se para përpilimit të dosjes së tenderit, projektet e përcaktuara të kenë specifikacionet e plota dhe të qarta të gjitha pozicioneve të punëve ndërtimore nga njësitë kërkuese në mënyrë që zbatimi i projekteve të realizohet në kohë dhe në mënyrë cilësore. |
| 7 | Investimet Kapitale | Ministri duhet të sigurojë nivelin adekuat të përgjegjësisë në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për dhënien e kontratës sipas kërkesave në Ligjin e Prokurimit Publik. |
| 8 | Pasuritë kapitale dhe jokapitale | Ministri duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat e sakta në lidhje me regjistrin e pasurisë. Veç kësaj, për projektet e përfunduara të finalizoj procesin për bartjen e pronësisë tek komuna dhe të njëjtat t'i heq nga regjistrat. |
| 9 | Pasuritë kapitale dhe jokapitale | Ministri duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë, siç parashihet me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Njëherësh të sigurojë se komisioni i inventarizimit do të bëjë krahasimin e gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të reflektoj ndryshimet eventuale në PVF. |
| 10 | Llogaritë e arkëtueshme | Ministri duhet të siguroj me rastin e përgatitjes së PVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme. |

| | | |
|----|---|--|
| 11 | Detyrimet e papaguara dhe kontingjent e | Ministri duhet të siguroj se asnjë ndarje e subvencioneve dhe granteve nga ana e komisioneve përkatëse nuk do të bëhet para se fondet të jenë të sigurta dhe të gatshme për pagesë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore. Problemet me alokimin e fondeve duhet të zgjidhen në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. |
| 12 | Funksioni i Auditimit të Brendshëm | Ministri/ Kryeshefi Ekzekutiv i AZHB-së duhet të sigurojë që NJAB e AZHB-së të jetë funksionale me kapacitete të mjaftueshme në mënyrë që të përfundoj auditimet e planifikuara me planin vjetor të punës dhe që fushëveprimi i NJAB-së të fokusohet në vitin aktual. |

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç 'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e konfirmimit

| | |
|--|--|
|  |  |
| <p>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA</p> <p>MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT</p> <p>LETËR E KONFIRMIMIT</p> <p>Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p> <p>Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit</p> <p>Të nderuar,</p> <p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p> <ul style="list-style-type: none">• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");• pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre. <p>z. Besian Mustafa </p> <p>Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</p> <p>Data: 14. Korrik 2020, Prishtinë</p> | |